REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.28 me datën 8 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon që:

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës ("Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës" Nr. 85/2010, nenit 12 par.12.2 dhe 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008) dhe nenit 20 pika d) të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur më ________2022 mori këtë:

**P R O P O Z I M**

# V E N D I M
# PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS: "BURIMET E UJIT" NË FSHATIN BAICË - SI MONUMENT I NATYRËS

1. Me këtë Vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës **"Burimet e Ujit"**, në fshatin Baicë të Komunës së Lipjanit, si Monument i Natyrës i karakterit hidrologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
   1.1. Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse prej 10 metra përfshinë sipërfaqen prej **5 ari.**
   1.2. Monumenti i Natyrës ka vlera natyrore të cilat i japin pamje karakteristike territorit të komunës së Lipjanit por edhe më gjerë.

2. Monumenti i Natyrës gjendet në pronë shoqërore, në parcelën 00001-0, zona kadastrale Baicë, nr. P-71409004-00001-0, me sipërfaqe 1585070 m$^2$, e regjistruar si pronë shoqërore.

3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Natural Monument/Natural Landmark – Monument i Natyrës.

4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi i shkallës së III-të të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat në monumentin e natyrës ndalohet:

4.1.Veprimtaritë të cilat e ndryshojnë gjendjen e tanishme të tij;
4.2.Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
4.3.Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;
4.4.Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur;
4.5.Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;
4.6.Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës;

4.7.Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;
4.8.Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;
4.9.Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së Monumentit Natyror.

5. Monumenti i Natyrës dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

5.1. Në Monumentin e Natyrës lejohen:
5.1.1. Të gjitha masat e mbrojtjes teknike të Monumentit Natyror nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit Natyror si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit Natyror.

6. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset komuna e Lipjanit, përmes drejtorisë përkatëse.
6.2. Komuna është e detyruar që:
6.1.2. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
6.1.3. Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
6.1.4.Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit Natyror në pajtim me Rregulloren për shënjimin e zonave të mbrojtura.

7. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet hidro-teknike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit Natyror.

8. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15-të) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hyn në fuqi shtatë (7-të) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare dhe në web-faqen zyrtare të komunës së Lipjanit.

1Nr. 1-011/01-14003
Lipjan, më 15.03.2022

Imri AHMETI

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT I LIPJAN OPŠTINA LIPLJAN REPUBLIKA KOSOVO




Harta e Monumentit Natyror “Burimet e Ujit”, në Baicë

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit*
*Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine*
*Ministry of Economy and Environment*

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE
KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

---

**INSTITUTI PËR MBROJTJEN E NATYRËS SË KOSOVËS**

# RAPORT
# MBI EVIDENTIMIN E VLERAVE TË NATYRËS NË TERRENIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

Prishtinë

Janar, 2021

**PËRMBAJTJA**

1. HYRJE

2. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

3. LISTA E OBJEKTEVE TË EVIDENTUARA GJATË NJOHJES SË VLERAVE

4. VIZITAT E REALIZUARA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

5. OBJEKTET QË IKMN DO TË PROPOZOJ PËR MBROJTJE LIGJORE

6. OBJEKTET QË MUND TË PROPOZOHEN PËR MBROJTJE NË TË ARDHMEN

7. LISTA E OBJEKTEVE (ZONAVE) NATYRORE QË INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS I PROPOZON KOMUNËS PËR MBROJTJE LIGJORE

8. REFERENCAT

9. PËRFUNDIM

## 1. HYRJE

Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës, është institucion i cili vepron në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Në strukturat e më hershme organizative, ky institucion ka bartur emërtime të ndryshme dhe ka funksionuar në kuadër të strukturave të tjera, deri më vitin 1989, kur Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë Ligjin për themelimin e **Entit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës** ("GZK" nr. 38/89). Ndërkaq që nga pas lufta, duke u nisur nga përshtatshmëria e rrethanave zhvillimore bashkëkohore, ky Institucion emërtohet si **Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës (IMNMK)**.

Me themelimin e Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, 2003, neni 39), Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit pëson ndryshime në emërim dhe tani quhet **Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN).**

IKMN-ja kryen punë me rëndësi në lëmin e Mbrojtjes së Natyrës me interes për Kosovën, si vijon:

- Përcjellë gjendjen e natyrës
- Mundëson kërkimin, studimin, evidentimin, valorizimin e natyrës, si dhe zbatimin e masave mbrojtëse të objekteve të natyrës
- Përgatitjen e bazave profesionale arsyeshmërisë, propozimeve dhe akteve për marrjen nën mbrojtje të objekteve të natyrës
- Mbajtjen e regjistrave dhe shënimeve për Zonat e Mbrojtura, konkretisht për Parqet, Rezervatet Natyrore, Monumentet Natyrore, Biodiveristetin etj
- Respektimi i Konventave Ndërkombëtare, koordinimi i punëve me organet kompetente komunale, Universitetin, OJQ-të, etj.

Kështu, në kuadër të strategjive dhe detyrave programore për vitin 2020 Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka realizuar projektin e evidentimit të vlerave natyrore nëpër komunat e Kosovës, e me këtë rast është realizuar edhe evidentimi i vlerave në komunën e Lipjanit. Gjatë evidentimit të vlerave natyrore në këtë komunë, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, ka shfrytëzuar tërë potencialin e kuadrove profesionale e teknike dhe ka realizuar:

- **8** vizita në terren
- Vizita evidentimi në të gjitha fshatrat e komunës së Lipjanit
- Evidentimin e **17**-të objekteve natyrore për mbrojtje të mundshme

Në këtë rast falënderojmë strukturat kompetente në Komunën e Lipjanit, për bashkëpunimin, e veçanërisht **z. Bajram Sinani**, nëpunës i urbanizimit, në Drejtorin për Planifikim, Urbanizëm, dhe Mjedis, në këtë komunë dhestafin e kësaj drejtorie. Po ashtu stafin e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe komunitetin lokal (njerëz të moshuar, intelektual, drejtor, kryetar të fshatrave, mësimdhënës etj) për dhënien e informacioneve të nevojshme gjatë realizimit të punës në terren.

## 2. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

### Pozita gjeografike

Komuna e Lipjanit ka pozitë të përshtatshme gjeografike, sepse gjendet në pjesën qëndrore të vendit dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit. Përmes territorit të saj rrjedh lumi Sitnica, përreth dhe përgjatë të cilit shtrihen sipërfaqet më të plleshme bujqësore, të përshtatshme për prodhimtarin bujqësore intensive. Gjithashtu, kjo komunë gjendet në afërsi të drejtpërdrejt të qendrave më të mëdha të rajonit si:

- Lipjan – Prishtinë 16 km
- Lipjan – Mitrovicë 37 km
- Lipjan – Prizren 60 km
- Lipjan – Gjakovë 96 km
- Lipjan – Pejë 96 km
- Lipjan – Podujevë 46 km
- Lipjan – Ferizaj 26 km
- Lipjan – Gjilan 30 km
- Lipjan – Aeroport 15 km

Territori i kësaj komune shtrihet në mes të gjerësisë gjeografike veriore 42° 44'–42° 52'dhe të gjerësisë lindore prej 18° 30'–18° 45'. Ka mundësi të volitshme të shfrytëzimit të trafikut rrugor-hekurudhor, si dhe atij ajror, meqenëse Airoporti gjendet në territorin e saj.Kështu që pozita e saj dhe vetë qyteti paraqet rrethinë mjaft të përshtatshme për zhvillimin e mëtjemë të komunës. Përmes territorit të kësaj komune kalon hekurudha, e cila lidh në të gjitha drejtimet me rajonin në tërësi.

Komuna e Lipjanit kufizohet, nga veriu dhed verilindja me komunën e Prishtinës, nga veriperëndimi me komunën e Fushë-Kosovës, nga perëndimi me komunën e Drenasit dhe të Malishevës, në jugperëndim me komunën e Shtimës, nga jugu me komunën e Ferizajt dhe nga lindja me komunën e Gjilanit dhe atë të Artanës.




Fig. 1. Harta e pozitës gjeografike të Lipjanit

## Veçoritë fiziko-gjeografike

## Relievi - Veçoritë morfologjike të hapësirës

Pjesa më e madhe e relievit të territorit të Komunës së Lipjanit është e përbërë nga sipërfaqe të rrafshëta me 44.53 %, nga ana jug-perëndimore, me 10.98 %, të lindjes, 4.03 % pjesa veriore, si më negative është kryesisht në terrenet e larta rreth 5.78 %, verilindore 7.96% dhe veri-perëndimore 6.71%. Territori i saj gjendet në lartësinë mbidetare mbi 500 metra ose 43.0 % e sipërfaqeve bruto gjenden në pjesën e rrafshët që do të thotë gjerë në 600 metra të lartësisë mbidetare të cilat janë edhe më të përshtatshme për prodhimtarinë bimore.

Kështu që në kuadër të këtyre sipërfaqeve gjendet numri më i madh I vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera si dhe lumenjve me degët e tyre të cilat përfshijnë rreth 6 % të territorit të përgjithshëm të Komunës. Në aspektin topografik të përthyeshmërisë së terrenit pjesa qendrore dhe kryesisht pjesa fushore ka topografi të but, ku distanca me dy izohipsave 10metra është disa qindra metra. Ndërsa pjesët lindore dhe perëndimore të Komunës karakterizohen me përthyeshmëri të madhe të terrenit të përberë nga disa qindra rrjedhe ujore kryesisht të përkohshme.

## Veçoritë klimatike

Komuna e Lipjanit ka klimë të mesme kontinentale me dimra relativisht të butë dhe verëra mesatarisht të nxehta dhe te thata. Temperaturat mesatarja vjetore e Lipjanit, është rreth 10.5 gradë celsius sipas IHMK, kështu që në viset malore, zbresin në 9 gradë celsius. Muajt më të nxehtë janë korriku dhe gushti më temperaturë mesatare 20,6 dhe 20,5 gradë celsius, ndërsa më i ftohti është janari më –1,4 gradë celsius. Maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është në gusht 37,3 gradë celsius, ndërsa minimumi –26,0 gradë celsius.

## Përbërjes gjeologjike

Në territorin e komunës së Lipjanit gjenden pothuajse të gjitha lëndët e para minerale, madje në sasi dhe cilësi të lartë, prej tyre më të rëndësishme janë lëndët minerale energjetike pikërisht linjiti. Pastaj, lëndët e para minerale të metaleve, rezervat e xehes së nikelit, pjesërisht hekurit, kromit, kobaltit etj, si dhe rezervat e lëndëve të para jo metalore, si: magnezitit, duniteve, materialeve të ndërtimit gëlqerorëve, rërë, zhavorr, rërë kuarci etj. Këto resurse janë premtuese për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të kësaj Komune.

### Ndërtimi gjologjik

Morfologjinë e relievit të hapësirës së Lipjanit e kanë përcaktuar fuqitë e brendshme dhe të jashtme gjatë një kohe të gjatë gjeologjike. Krijimi i hapësirës së kësaj komune nuk mund të shikohet si hapësire e ndarë nga ajo e vendit. Ndërtimi gjeologjik i Lipjanit përbëhet kryesisht prej shkëmbinjve metamorfik si mermerëve, kuarciteve, duniteve, gëlqerorëve, por marrin pjesë

edhe formacionet e reja si depozitimet ranore dhe rëra argjilore e rrafshinave aluviale të lumit Sitnica dhe degëve të saj. Në të dy anët e këtij lumi mbi rrafshinat aluviale janë të përhapura sendimentet liqenore të pliocenit. Ato janë të përfaqësuar me argjila ranore dhe mergele. Si një rezultat i një ndërtimi gjeologjik të llojllojshëm kemi një larmi të mineraleve të metaleve: rezervat e xehes së nikelit, pjesërisht hekurit, kromit, kobaltit etj. Pastaj kemi rezervat e lëndëve të para jo metalore, rezervat e magnezitit, duniteve, materialeve të ndërtimit të gëlqerorëve, rërave kuarcore, rërave e zhavorreve etj.

## Karakteristikat pedologjike

Tipet më të përfaqësuara të tokave në territorin e komunës së Lipjanit janë smonicat me më tepër se 25.24 % të cilat me përjashtim të smonicave të eroduara sipas cilësive të veta dhe karakteristikave prodhuese janë toka mjaft të mira, të thella, kryesisht të përbërjes së argjilës së pasura me humus dhe kalium aktiv.

Pjesët në të cilat janë të koncentruar vendbanimet janë toka aluviale. Në perëndim dhe veri të vendbanimeve janë zonat që përmbajnë tokat të tipit smonicë. Në verilindje të vendbanimeve janë pjesët me smonicë jo-karbonate. Pjesa më e madhe e tokave i përkasin klasës së bonitetit II, III dhe IV, tokat e klasës së bonitetitI dhe II përfshijnë 23% të sipërfaqes së përgjithshme bujqësore. Struktura e sipërfaqeve është relativisht e përshtatshme meqenëse në tokat bujqësore bëjnë pjesë më tepër se 60 % e sipërfaqes së përgjithshme të territorit të kësaj komune. Ato pyjore rreth 35 % dhe në tokat jo pjellore 19 % të cilat i takojnë klasave të bonitetit VII dhe VIII, të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhimtarinë bujqësore.

## Veçoritë hidrografike

Në aspektin hidrografi ujërat në komunën e Lipjanit i takojnë pellgut të Detit të zi, ndërsa lumenjtë më të mëdhenj janë lumi Sitnica dhe Drenica, të cilët janë nën degë të lumit Ibër. Në përgjithësi rrjeti hidrografik është me potencial ujorë të varfër, i kushtëzuar nga sasia e vogël e reshjeve mesatare shumëvjeçare (600mm). Lumi Sitnica është lumi më i madh në këtë komunë dhe degët më të zhvilluara i ka në anën lindore. Ndërsa degët kryesore hidrografike të anës lindore janë: lumi Janjevka, lumi i Zhegovcit, lumi i Gadimës dhe lumi i Sazlisë, kurse, në anën perëndimore lumi më i zhvilluar është lumi i Vërshevcit. Sasitë më të mëdha të reshurave janë

gjatë muajit prill dhe maj, prandaj periudha pranverore është ajo kur paraqiten vërshimet dhe kur kemi edhe paraqitjen e kënetave, posaçërisht në tokat të cilat nuk e lëshojnë ujin.

## Biodiversiteti

**Pyjet** – komuna e Lipjanit paraqitet në ndarje të tërthortë në rrafsh të Fushë Kosovës e rrafsh lartat e Blinajës, Caralevës dhe Drenicës, në perëndim dhe rrafsh lartat e rrafshit të Androvackës në lindje. Rezervati i gjuetisë 'Blinaja" një zonë e madhe pyjore e mbrojtur shtrihet në male në jugperëndim.

Sipërfaqja e përgjithshme me pyje në kësaj komunë është:1621.023 ha janë pyje të larta, 2993.21 ha pyje të ulëta, 11038.16ha janë shkurre.

Zonat malore shquhen me potencial të madh për zhvillimin e turizmit bazuar në natyrë si: Blinaja, bukurit e pasazheve Shalë-Kleçkë dhe vargmalet e zhegovcit. Këto zona paraqesin habitat për shumë lloje të faunës, të cilat gjenden në këtë pjesë.

Nga e tërë ajo që u tha më lart mund të vijmë në përfundim si vijon:

- **Mbrojtja adekuate e biodiversitetit**
- **Të merren masa për mbrojtjen e llojeve të rrezikuarabimore dhe shtazore dhe arealeve të tyre**
- **Të ruhen lokalitetet të cilat janë korridore ekologjike të shtazëve të egra**
- **Të kontrollohet gjuetia në mënyrë institucionale**

## 3. LISTA E OBJEKTEVE TË EVIDENTUARA GJATË NJOHJES SË VLERAVE

| Nr | Vendi | Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare | Komuna |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | X | Y | | |
| 1 | Baicë | Burimet e ujit | 0492363 | 4707627 | 637 | Lipjan |
| 2 | Baicë | Trungu i Bungëbutës *(Quercus pubescens)* | 0492616 | 4707323 | 633 | Lipjan |
| 3 | Bregu i zi | Trungu i Shpardhit *(Quercus frainetto)* | 0504483 | 4702746 | 583 | Lipjan |
| 4 | Bujan | Pylli në varreza | 0506283 | 4703532 | 659 | Lipjan |
| 5 | Blinajë/Vërshevc | Trungjet e dushkut *(Quercus sp.)* | 0500485 | 4708279 | 595 | Lipjan |
| 6 | Dobrajë e madhe | Trungu i Bungëbutës *(Quercus pubescens)* | 0503788 | 4709691 | 554 | Lipjan |
| 7 | Gadime e epërme | Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* | 0519233 | 4703766 | 637 | Lipjan |
| 8 | Krojmir | Guri te Kroni | 0494048 | 4703577 | 661 | Lipjan |
| 9 | Poturoc | Trungu u Rrënjës *(Quercus robur)* | 0503646 | 4708266 | 560 | Lipjan |
| 10 | Resinoc | Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* | 0494243 | 4707632 | 642 | Lipjan |
| 11 | Sllovi | Trungjet e Qarrit *(Quercus cerris)* | 0519061 | 4707734 | 624 | Lipjan |
| 12 | Sllovi | Trungu i Shpardhit *(Quercus frainetto)* | 0519062 | 4707113 | 632 | Lipjan |
| 13 | Smallushë | Trungjet e Shpardhit *(Quercus frainetto)* | 0516311 | 4706053 | 615 | Lipjan |
| 14 | Smallushë | Trungjet e Shpardhit *(Quercus frainetto)* | 0517384 | 4706019 | 609 | Lipjan |
| 15 | Smallushë | Trungu i Dushkut *(Quercus sp.)* | 0516300 | 4706049 | 601 | Lipjan |
| 16 | Vrellë | Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* | 0522184 | 4703816 | 717 | Lipjan |
| 17 | Torinë | Pylli i dushkut | 0505336 | 4708419 | 575 | Lipjan |

## 4. VIZITAT E REALIZUARA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJNAIT

Ekipi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në bashkëpunim me **z. Bajram Sinani,** nënpunës i urbanizimit në komunën e Lipjanit, me datën: 07.07.2020, ka evidentuar vlerave natyrore në komunën respektive. Gjatë kësaj kohe janë realizuar vizitat në terren,në të gjitha vendbanimet e kësaj komune, duke përfshirë edhe vendbanimet të cilat janë vizituar gjatë vitit 2006.

## 5. OBJEKTET QË IKMN DO TË PROPOZOJ PËR MBROJTJE LIGJORE

### 1. Fshati BAICË

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**1.1. Burimet e Ujit** – këto burime uji njihen me emrin banja e Baicës. Uji i këtyre burimeve (sipas banorrëve lokal) "*ka rëndësi në aspektin shëndetsor, sepse në vete përmban veti shëruese për sëmundja e lukthit dhe të lëkurës"* (foto 1 dhe 2).



Foto 1



Foto 2

**1.2. Trungu i Bungëbutës *(Quercus pubescens)*** – ky trung ndodhet në varrezat e fshatit Baicë dhe gjendja e tij është shumë e mirë. Lartësia e trungut arrinë deri në 20 – 25 metra, perimetri nga 3.5 metra, kurora rreth 15 metra dhe mosha e tyre 250 – 300 vite (foto 3 dhe 4).



Foto 3



Foto 4

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Burimet e Ujit** | 0492363 | 4707627 | 637 |
| **Trungu i Bungëbutës *(Quercus pubescens)*** | 0492616 | 4707323 | 633 |

## 2. Fshati BREGU I ZI

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**2.1. Trungu i Shpradhit *(Quercus frainetto)*** – ky trung gjendet në varrezat e fshatit Bregu i zi. Latrësia e trungut arrinë 20 metra, perimetri 2.5 metra, kurora 15 metra, kurse mosha 250 vite (foto 5 dhe 6).



Foto 5



Foto 6

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Trungu i Shpradhit** ***(Quercus frainetto)*** | 0504483 | 4702746 | 583 |

## 3. Fshati DOBRJAË E MADHE

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**3.1.Trungu i Bungëbutës** ***(Quercus pubescens)*** – i cili gjendet në varrezat e fshatit Dobrajë e madhe. Latrësia e trungut arrinë 20 metra, perimetri 4 metra, kurora 15 metra, mosha 350 – 400 vite (foto 7 dhe 8).



Foto 7



Foto 8

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Trungu i Bungëbutës** ***(Quercus pubescens)*** | 0503788 | 4709691 | 554 |

## 4. Fshati GADIME E EPËRME

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**4.1. Trungu i Qarrit** ***(Quercus cerris)*** – trungu ndodhet në varrezat e fshatit Gadime e eperme dhe gjendja e përgjithshme e tij është e mirë. Lartësia e trungut arrinë 25 metra, perimetri 3 metra, kurora 30 metra, kurse mosha 200 – 250 vite (foto 9 dhe 10).



Foto 9



Foto 10

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Trungu i Qarrit** ***(Quercus cerris)*** | 0519233 | 4703766 | 637 |

## 5. Fshati KROJMIR

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**5.1. Guri te Kroni** – ky guri ndodhet në afërsi të burimi të ujit, në fshatin Krojmir, dhe pamja e tij është mjaft karekteristike në aspektin gjeomorfologjik. Gjatësia e tij është rreth pesë (5) metra, kurse lartësia rreth katër (4-rë) metra dhe ka ngjyrë të mbylltë me shkëlqim, nuk ka shumë të qara në të dhe si i till paraqet atraksion të rëndësishëm edhe në aspektin turistik (foto 11 dhe 12).



Foto 11



Foto 12

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Guri te Kroni** | 0494048 | 4703577 | 661 |

## 6. Fshati POTUROC

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**6.1. Trungu i Rrënjës *(Quercus robur)*–** trungu ndodhet në oborrin e shtëpisë së z. Muharrem Sadikut dhe gjendja e tij është shumë e mirë. Lartësia e trungut arrinë 22 metra, perimetri 3.5 metra, kurora 20 metra, kurse mosha 200 – 250 vite (foto 13 dhe 14).



Foto 13



Foto 14

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Trungu i Rrënjës *(Quercus robur)*** | 0503646 | 4708266 | 560 |

## 7. Fshati RESINOC

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**7.1. Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)*** – trungu ndodhet në oborrin e shkollës së fshatit Resinoc dhe gjendja e përgjithshme e tij është e mirë. Lartësia e trungut arrinë 18 - 20 metra, perimetri 2.5 metra, kurora 14 metra, kurse mosha 150 – 200 vite (foto 15 dhe 16).



Foto 15



Foto 16

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)*** | 0494243 | 4707632 | 642 |

## 8. Fshati SMALLUSHË

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**8.1. Trungjet e Shpradhit *(Quercus frainetto)*** – këto trungje ndodhen në oborrin e Ambulancës dhe në afërsi të shkollës së fshatit Smallushë. Njëra degë është e kalbur në rrënjë. Lartësia e trungjeve arrinë 18 metra, perimetri 2, kurora 20 metra dhe mosha 150 – 200 vite (foto 17 e 18).



Foto 17



Foto 18

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Trungjet e Shpardhit *(Quercus frainetto)*** | 0516311 | 4706053 | 615 |

## 6. OBJEKTET QË MUND TË PROPOZOHEN PËR MBROJTJE NË TË ARDHMEN

### 1. Fshati Bujan

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**1.1. Pylli në varreza** – trungjet gjenden në afërsi të shkollës, në varrezat e fshatin Bujan (foto 1 dhe 2).



Foto 1



Foto 2

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Pylli në varrëza** | 0506283 | 4703532 | 659 |

### 2. Fshati Blinajë/Vërshevc

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**2.1. Trungjet e Dushkut *(Quercus sp.)*** – trugjet gjenden në varrezat e fshatit Blinajë (foto 3 dhe 4).



Foto 3



Foto 4

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Trungjet e Dushkut *(Quercus sp.)*** | 0500485 | 4708279 | 595 |

## 3. Fshati Sllovi

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**3.1. Trungu i Shpradhit *(Quercus frainetto)*** – trungu gjendet në oborrin e shkollës së fshatit Sllovi (foto 5 dhe 6).



Foto 5



Foto 6

**3.2.Trungu i Qarrit** ***(Quercus cerris)*** – tungu gjendet në varrezat e fshatit Sllovi (foto 7 dhe 8).



Foto 7



Foto 8

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Trungu i Shpradhit** ***(Quercus frainetto)*** | 0519062 | 4707113 | 632 |
| **Trungu i Qarrti** ***(Quercus cerris)*** | 0519061 | 4707734 | 624 |

## 4. Fshati Smallushë

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**4.1. Trugjet e Shpardhit** ***(Quercus frainetto)*** – këto trungje gjenden në lagjen e vendin e quajtur "Lagja e Pacollëve", në të cilat janë vërejtur ndërhyjre të faktorit njeri (foto 9 dhe 10).

**4.2. Trungu i Dushkut** ***(Quercus sp.)*** **të cilat** gjenden disa dhjetra metra larg prej shkollës.



Foto 9



Foto 10

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Trungjet e Shpradhit** ***(Quercus frainetto)*** | 0517384 | 4706019 | 609 |
| **Trugu i Dushkut** ***(Quercus sp.)*** | 0516311 | 4706053 | 615 |

## 5. Fshati Vrellë

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**4.1.Trungu i Qarrit** ***(Quercus cerris)***– ky trung gjendet në fshatin Vrellë (foto 11 dhe 12).



Foto 11



Foto 12

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Trungu i Qarrit** ***(Quercus cerris)*** | 0522184 | 4703816 | 717 |

## 5. Fshati Torinë

Në këtë lokalitet është konstatuar si në vijim:

**5.1.Pylli i Dushkut** ***(Quercus sp.)*** – ky pyll gjendet në fshatin Torinë.

| Objekti | Koordinatat | | Lartësia mbidetare |
|---|---|---|---|
| | X | Y | |
| **Pylli i Dushkut** ***(Quercus sp.)*** | 0505206 | 4708381 | 566 |

## 7. LISTA E OBJEKTEVE (ZONAVE) NATYRORE QË INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS I PROPOZON KOMUNËS PËR MBROJTJE

Stafi profesional i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, pas përmbledhjes përfundimtare të raporteve të evidentimit të vlerave natyrore, në territorin e komunës së Lipjanit dhe pas një analize të secilit objekt veç e veç, në bazë të kritereve të cilat përcaktojnë shpalljen e një objekti apo zone si të mbrojtur vjen me këtë përfundim.

Duke marrë parasysh vlerën natyrore, shkencore, kulturore, edukative, arsimore dhe historike të objekteve të poshtëshënuara iu sugjerojmë organeve përgjegjëse komunale të komunës së Lipjanit, që duke ndjekur procedurat ligjore në fuqi, e sipas udhëzimeve të dhëna në shkresë të këtij raporti, të lëshuar nga ana e Drejtorit të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, që të aprovoi iniciativën tonë për mbrojtjen ligjore të objekteve/zonave të poshtëshënuara:

1. **Burimet e Ujit në fshatin Baicë**
2. **Trungu i Bungëbutës *(Quercus pubescens)* në fshatin Baicë**
3. **Trungu i Shpardhit *(Quercus frainetto)* në fshatin Bregu i zi**
4. **Trungu i Bungëbutës *(Quercus pubescens)* në fshatin Dobrajë e Madhe**
5. **Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* në fshatin Gadime e epërme**
6. **Guri te Kroni në fshatin Krojmir**
7. **Trungu i Rrënjës *(Quercus robur)* në fshatin Poturoc**
8. **Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* në fshatin Resinoc**
9. **Trungjet e Shpardhit *(Quercus frainetto)* në fshatin Smallushë**




| FID | Shape * | Nr | Vendi | Emertimi | X | Y | Z |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0 | Point | 1 | Baicë | Burimet e ujit | 492363 | 4707627 | 637 |
| 1 | Point | 2 | Baicë | Trungu Bungëbutës (Quercus pubescens) | 492616 | 4707323 | 633 |
| 2 | Point | 3 | Bregu i zi | Trungu i Shpardhit (Quercus frainetto) | 504483 | 4702746 | 583 |
| 3 | Point | 4 | Dobrajë e madhe | Trungu Bungëbutës (Quercus pubescens) | 503788 | 4709691 | 554 |
| 4 | Point | 5 | Gadime e eperme | Trungu i Qarrit (Quercus cerris) | 519233 | 4703766 | 637 |
| 5 | Point | 6 | Krojmir | Guri te Kroni | 494048 | 4703577 | 661 |
| 6 | Point | 7 | Poturovc | Trungu i Rrënjës (Quercus robur) | 503646 | 4708266 | 560 |
| 7 | Point | 8 | Resinoc | Trungu i Qarrit (Quercus cerris) | 494243 | 4707632 | 642 |
| 8 | Point | 9 | Smallushë | Trungjet e Shpardhit (Quercus frainetto) | 516311 | 4706053 | 615 |

**Harta e Monumenteve Natyrore të evidentuara në komunën e Lipjanit**

## 8. REFERENACAT


- Dokumentacioni nga Arkivi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233
- Raproti përfundimtar Lipjan – IKMN, 30.11.2006
- Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Lipjanit 2016-2020
- Plani Rregullues "Qendra" Lipjan
- Plani Zhvillimor Komunal i Lipjanit 2013 – 2023+
- Plani Zhvillimor Urban, 2013 – 2018 +
- Libri i Kuq i Florës Vaskulare i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2013, Dr. Ferat Rexhepi, Dr. Fadil Millaku, Dr. Elez Krasniqi, Dr, Qazim Pajaziti, Mr. Xhavit Mala, Mr. Naim Berisha
- Atlasi i Bimëve të Kosovës, Dr. Ferat Rexhepi, Dr. Fadil Millaku, Mr, Xhavit Mala, Behxhet Berisha
- Dokumentacioni nga Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës në Komunën e Lipjanit
- Harta topografike e Kosovës 1 : 25000

## 9. PËRFUNDIM

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës është i hapur për bashkëpunim sikurse për të gjitha komunat edhe për komunën tuaj për të gjitha çështjet me interes të mbrojtës së natyrës dhe vlerave të saj. Me kënaqësi do të pranonim çdo sugjerim, vërejtje apo këshillë nga ana juaj lidhur me këtë raport.

Po ashtu, Instituti i Kosovës për Mbrotjen e Natyrës ju sugjeronë që të merrni masa ligjore për mbrojtjen e vlerave natyrore të lartpërmendura. Në të kundërtën edhe këto do të kenë fatin e shumë vlerave natyrore të dëmtuara e të asgjësuara nga faktorë të ndyshëm natyror, si dhe antropogjen.

Në dyzetë e shtatë (47-të) vendbanime në komunën e Lipjanit, nuk është gjetur ndonjë objekt i rëndësishëm për mbrojtje, por mbetet që këto këto zona të hulumtohen në të ardhmen.

**Punimet në terren u realizuan nga:**

**Msc. Nexhmije Kamberi**: biologe – IKMN

**Dr. sc. Qenan Maxhuni**: biolog – IKMN

**Dr.sc. Sami Behrami**: gjeograf – IKMN

**Abdurrahman Verbovci**: gjeograf – IKMN

**Bajram Sinani**: inxh. i arkitekturës – DUPM/komunë

**Raportin e përgjithshëm e përgatiti:** **Prishtinë, IKMN**

**Msc. Nexhmije Kamberi** **25.01.2021**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.28 me datën 8 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon që:

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës ("Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës" Nr. 85/2010, nenit 12 par 12.2 dhe nenit 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008) dhe nenit 20 pika d) të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur më ________2022 mori këtë:

**PROPOZIM**

**VENDIM**
PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS: **"TRUNGU I BUNGËBUTËS *(QUERCUS PUBESCENS )*"** NË BAICË SI MONUMENT I NATYRËS

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës **"Trungu i Bungëbutës *(Quercus pubescens )*"**, në fshatin Baicë të Lipjanit, si Monument i Natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
   1.1. Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse rreth projeksionit të kurorës prej 10 metra përfshinë sipërfaqen prej **5 ari.**
   1.2. Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm për territorin e komunës së Lipjanit por edhe më gjerë.
   1.3. Lartësia e kërcellit të Monumentit Natyror është rreth 20 – 25 metra, perimetri i kërcellit është 3.5 metra, diametri i kurorës 15 metra dhe vjetërsia është mbi 250-300 vite.

2. Monumenti i Natyrës gjendet në varrezat e fshatit, në pronë shoqërore, në parcelën 00473-0, zona kadastrale Baicë, nr. P-71409004-00473-0, me sipërfaqe 12316 $m^2$, e regjistruar si pronë shoqërore.

3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të. Natural Monument/Natural Landmark – Monument i Natyrës.

3.1. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- 3.1.1. Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
- 3.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
- 3.1.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;
- 3.1.4. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;
- 3.1.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;
- 3.1.6. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës;
- 3.1.7. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera
- 3.1.8. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;
- 3.1.9. Ndërrimi i kulturës;
- 3.1.10. Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së Monumentit Natyror.

4. Monumenti i Natyrës dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

   4.1. Në Monumentin e Natyrës lejohen të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit Natyror nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit Natyror si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit Natyror.

5. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset komuna e Lipjanit, përmes drejtorisë përkatëse.

   5.1. Komuna është e detyruar që:

   - 5.1.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
   - 5.1.2. Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetit e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
   - 5.1.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit Natyror në pajtim me Rregulloren për shënjimin e zonave të mbrojtura.

6. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomike-pyjore, hidro-teknike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit Natyror.

7. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15-të) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hyn në fuqi shtatë (7-të) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare dhe në web-faqen zyrtare të komunës së Lipjanit.

1Nr. 1-011/01-14030
Lipjan, më 15.03 2022

Imri AHMETI

Kryetari i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
LIPJAN
OPŠTINA LIPLJAN
REPUBLIKA KOSOVO




Harta e Monumentit Natyror "Trungu i Bungëbutës *(Quercus pubescens)*", në Baicë

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.28 me datën 8 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon që:

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës ("Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës" Nr. 85/2010, nenit 12 par.12.2 dhe nenit 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008) dhe nenit 20 pika d) të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur më ________2022 mori këtë:

**P R O P O Z I M**

**V E N D I M**

PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS: **"TRUNGU I SHPARDHIT (*QUERCUS FRAINETTO*)"** NË FSHATIN BREGU I ZI SI MONUMENT I NATYRËS

